


PERFORMANCA E AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS NËPËRMJET RAPORTIT TË VITIT

2017



PLANI I PUNËS I AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS

2018

Raporti vjetor i Agjensisë Kadastrale të Kosovës

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) paraqet raportin përmbledhës me aktivitetet e realizuara në periudhën Janar – Dhjetor 2017, i cili bazohet në objektivat e parapara nga plani i punës së AKK-së për vitin 2017, si dhe Planin e Punës për vitin 2018.

PËRMBAJTJA

1. BUXHETI	6
2. ZHVILLIMI DHE HARMONIZIMI I MËTUTJESHËM I INFRASTRUKTURËS LIGJORE MBI PRONËN E PALUAJTSHME	8
3.ZGJERIMI I SISTEMIT TË SISTEMIT TË INFORMACIONEVE KADASTRALE TË TOKËS NË KOSOVË DREJ ARKITEKTURËS TË ORIENTUAR NË SHËRBIME (SIKTK-AOSh) (KCLIS – SOA)	11
4. SISTEMI I INFORMACIONEVE KADASTRALE TË TOKËS NË KOSOVË - HARTA KADASTRALE	11
5. ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS KOMBËTARE TË TË DHËNAVE HAPËSINORE -IKIH (ANG.NSDI) DHE GIS-IT	12
6. REGJISTRIMI SISTEMATIK I PRONAVE TË PALUAJTSHME	14
7. SHPRONËSIMI	15
8.KRIJIMI I SISTEMIT TË ARKIVIMIT DIGJITAL	16
9. SISTEMI I POZICIONIMIT SATELITOR TË KOSOVËS - KOPOS	18
10. GJEOPORTALI SHTETËROR	19
11. ZHVILLIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT	20
12. GJITHPËRFSHIRJA NË TË DREJTA PRONËSORE	26
13. BASHKËPUNIMI ME DONATORE	27
14. LOGJISTIKA	28
15. PLANI VJETOR I PUNËS SË AKK PËR VITIN 2018	29

“Agjencia Kadastrale e Kosovës administrohet nga Zyra Ekzekutive, pesë Drejtorate
dhe Zyra për Koordinim të Projekteve ”



Prof. Dr Murat Meha
Kryeshef Ekzekutiv
Agjencia Kadastrale e Kosovës
murat.meha@rks-gov.net



Avni Ahmeti
Drejtore i Drejtoratit për Kadastër
Agjencia Kadastrale e Kosovës
avni.ahmeti@rks-gov.net



Fazile Hamiti
Drejtoreshë e Drejtoratit për Administratë dhe Financa
Agjencia Kadastrale e Kosovës
fazile.hamiti@rks-gov.net



Afërdita Thaçi
Drejtoreshë e Drejtoratit për Teknologjisë së Informacionit
Agjencia Kadastrale e Kosovës
aferdita.thaci@rks-gov.net



Ismet Kryeziu
Drejtore i Drejtoratit Ligjor
Agjencia Kadastrale e Kosovës
ismet.kryeziu@rks-gov.net



Muzafer Çaka
Udhëheqës i Zyrës për Koordinimin e Projekteve
Agjencia Kadastrale e Kosovës
muzafer.caka@rks-gov.net

Fjala e Kryeshefit Ekzekutiv

Avancimet e vazhdueshme në administrimin e tokës, të cilat janë dëshmuar edhe në raporte të institucioneve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare janë rezultat i ekspertëve vendor e ndërkombëtar. Këta me punën e tyre profesionale krijuan performancë shumë të mirë të kadastrit dhe administrimit të tokës në Republikën e Kosovës, ndaj dua të falënderoj të gjithë për performancë të realizuar. Që në fillim dua të ua kujtoj se Agjencia Kadastrale e Kosovës, është autoriteti më i lartë për Kadastrë, Gjeodezi, Hartografi dhe Gjeoinformacion në Republikën e Kosovës. Po ashtu, AKK është përgjegjëse për administrimin e sistemit shtetëror kompjuterik për pronat e paluajtshme, është përgjegjëse për regjistrimin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme dhe për Sistemin e Adresave. Pra siç shihet Kadastrë është interes publik, ndaj Agjencia Kadastrale e Kosovës është institucion tepër profesional dhe specifik, edhe funksionimi i saj është kompleks dhe i pa ndarë. Funksionimi dhe veprimtaria e Agjencisë Kadastrale të Kosovës edhe në vitin 2017 ka treguar suksese, që nga mbledhja, përpunimi dhe shërbimi me të dhëna kadastrale për gjithë territorin e Kosovës. Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) si organ i shkallës së dytë, është mbikëqyrës i Zyrave Kadastrale Komunale (ZKK), të cilat bëjnë regjistrimin e pronës së paluajtshme. AKK, vepron në bazë të Ligjit me nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave të Pronave të Paluajtshme, Ligjit me nr. 04/L-013 për Kadastrë, Ligjit 2002/4 për Hipotekat dhe Ligjit me nr. 02/L28 për Procedurën Administrative, pa anashkaluar edhe ligjet tjera si: Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Pronësore, Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligji për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit etj. Projektet e realizuara deri më tani

kanë bërë që sot të kemi kadastrë të sigurtë, të sakët dhe të administruar mirë. Për secilën parcelë të tokës dihet pronari i saj, dihen të drejtat mbi të, është duke u krijuar tatimi në pronë dhe çdo vit është duke u realizuar kolateral i lartë me interes për zhvillim ekonomik shtetëror dhe për ekonominë familjare. Të gjitha këto kanë ndikuar në ngritjen e vlerës së tokës dhe në ngritjen e sigurisë së saj, rrjedhimisht edhe në ngritjen e mirëqenies sociale të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Agjencia Kadastrale gjatë vitit 2017 ka vazhduar me Infrastrukturën e Informacioneve Gjeohapsinore, respektivisht me harmonizimin dhe shpërndarjen e të dhënave gjeohapsinore. Republika e Kosovës ka krijuar bazën e mirë të Gjeoportait Shtetërorë, duke përcaktuar standardet për harmonizim dhe shpërdajen e të dhënave. Kjo infrastrukturë ndihmon menaxhimin e situatave të krizës, krijimin e qasjes së lehtë dhe të shpejtë në të dhënat e sigurta, lehtëson vendimmarrjen. Mbi të gjitha, kjo infrastrukturë gjeohapsinore sipas Direktivës INSPIRE 2007 të EU është obliguese për të gjitha shtetet e BE-së, që do të thotë duhet edhe ne të i përmbushim ato kritere, ngase aspirojmë në BE. Në vazhdim janë numëruar disa nga projektet e realizuara apo të vazhduara në vitin 2017. Janë kontrolluar elaboratet e shpronësimit sipas kërkesave nga Departamenti i shpronësimeve në kuadër të MMPH-së. Kanë vazhduar trajnimet dhe përkrahja e AKK-së për mbarëvajtjen e punëve në ZKK dhe në sektorin privat. Janë realizuar mbështetje profesionale drejtpërdrejtë në ZKK nga aspekti i TI, kadastrit dhe gjeoinformacionit. Janë monitoruar punët profesionale të Zyrave Komunale Kadastrale (ZKK), dhe janë hartuar raporte konkrete për secilën ZKK. AKK së bashku me Ministrin e Drejtësisë kanë hartuar vendimin dhe listën e pronave të cilin e aprovoi Qeveria e Kosovës, që të gjitha pronat e paluajtshme të regjistruara në emër të Republikës Socialiste

Federative të Jugosllavisë, përkatësisht të Republikës së Jugosllavisë, të Republikës Socialiste të Serbisë, përkatësisht të Republikës së Serbisë dhe të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, duke përfshirë, por pa u kufizuar në organet e tyre shtetërore, administrative, ushtarake dhe ish organizatat shoqërore-politike të regjistruhen në emër të Republikës së Kosovës si pronare e këtyre pronave të paluajtshme dhe ka bërë ndryshimet në Sistemin e Informacioneve Kadastrale të Tokave në Kosovë sipas këtij vendimi; Strategjia pesë vjeçare e AKK-së për Teknologji të Informacionit (2017-2021), është hartuar e aprovuar dhe vazhdon implementimi i saj. Projekti për skanimin e dokumenteve arkivore kadastrale është realizuar sipas dinamikës së paraparë. Është realizuar Projekti për zgjerimin dhe avancimin e aplikacionit, Sistemi i Informacionit Kadastral për Tokën në Kosovë (SIKTK) në drejtim të arkitekturës të orientuar për shërbime (SOA) Për shkaqe sigurie, Qendrën Shtetërore e të Dhënave, si qendra e dytë e të dhënave në raste emergjente (DRC) është zhvendosur, nga objekti i MPB-Deçan në Prishtinë. Sfidë kryesore për AKK-në në 6 muojat e parë të vitit 2017 ishte rregullorja e re e përgatitur nga Ministri i Sekretari i MMPH-së (2017) pa konsultime me AKK, pa i përfillur analizat dhe eksperiencat profesionale, lidhur me riorganizimin e AKK-së, pa i lexuar i lexuar komentet nga ekspertët e AKK-së dhe ekspertet ndërkombëtar dhe pa i marrë parasysh specifikat e institucionit. Ndoshta vlerësimi më i lehtë që mund të thuhet në këtë rast është se MMPH nëpërmjet të këtij riorganizimi beri demolimin e AKK-së. Fatmirësisht kjo rregullore është stopuar, për ta analizuar edhe një herë pas ndërrimit të udhëheqjes në MMPH. Uroj që viti 2018 të vazhdojë me realizimin e suksesshëm të projekteve në Agjencinë Kadastrale duke ngritur edhe më tej performancën e saj, duke ofruar të dhëna të sakta dhe duke ofruar shërbime kualitative dhe të shpejta.



1. BUXHETI

AKK ka dorëzuar Raporti Vjetor Financiar për vitin 2016 në MMPH. Raporti është përgatitur sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik, i cili raport i përmbush të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

Pas aprovimit të buxheti për vitin 2017 nga Kuvendi i Kosovës, bazuar në kërkesat e njësive kërkuuese në AKK, është përgatitur plani i alokimit të mjeteve për vitin fiskal 2017, për të

Sipas Rregulloreve të MFK-së – Procedurat e MFK-së Nr.1, është përgatitur "Deklarata e Menaxhmentit Për Menaxhimin e Financave dhe Kontrollit", është aprovuar nga ZKA dhe është dërguar në MF. AKK ka përgatitur "Pyetësin e Vetëvlerësimit të Komponentëve të Menaxhmentit Financiar dhe Kontrollit". Pyetësi në përmbajtjen e vet ka 107 pyetje, të cilat lidhen me rregullat kryesore të funksionimit të brendshëm si: objektivat strategjike, rregullat e brendshme, struktura organizative, politika e burimeve njerëzore etj. Ky pyetësor pas aprovimit është dërguar në MF.

Mjetet e pashpenzuar nga donacioni barten në vitin vijues 2018.

gjitha kategoritë ekonomike. Kërkesa është dërgua në MMPH-MF pas aprovimit nga personi përgjegjës.

Bazuar në LMFP dhe procedurat e MFK-së, në bashkëpunim me Drejtoratet e AKK-së është përgatitur "Regjistri i rrezikut". Në këtë formular janë trajtuar objektivat, masat, prioritetet, projektet, përshkrimi i rrezikut, veprimet që duhet ndërmarrë, afatet e fundit kohore, sektorët përgjegjës, realizimi i planit, etj. Pas aprovimit nga ZKA është dërguar në MF.

AKK ka përgatitur propozimet për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) për vitet 2018-2020. KASH është përgatitur në bazë të kërkesave të njësive kërkuuese – Drejtorateve, e cila në përmbajtjen e saj ka: Misionin, Situatën aktuale, Objektivat, Tabelën financiare me vlerësime 2016-2017 dhe vlerësimet 2018-2020 për kategoritë Paga, Malla dhe Shërbime, Kapitale, Komunal. Bazuar në kërkesën e MF, AKK ka përgatitur kërkesën për Rishikimin e Buxhetit për vitin 2017.

Me këtë kërkesë është kërkuar plotësim i mjeteve të pagat në vlerë prej 18 703.63€, korrigjim i dy kodeve ekonomike si dhe transfer/rialokim i mjeteve të projektet kapitale (Kadastri i ndërtesave – Rindërtimi i informacioneve kadastrale). Kërkesa pas aprovimit është dërguar në MMPH-MF.

Me kërkesën e MF, AKK ka përgatitur planifikimin e buxhetit për vitin 2018-19-20. Planifikimi i buxhetit është bërë në bazë të kërkesave të Drejtorëve të AKK-së, të ndara sipas kategorive ekonomike (Paga, M&SH, Kapitale dhe Komunal). Pjesë e këtij planifikimi është edhe planifikimi i të hyrave për vitin 2018.

MF bazuar në Vendimin e Qeveris ka reduktuar mjetet nga buxheti i AKK-ës të projektet kapitale. Reduktimi mjeteve të dy projekte kapitale, "Skenimi i dokumenteve kadastrale" dhe "Rindërtimi i informacioneve kadastrale" në vlerë – 80%. Te pesë projekte tjera reduktimi i mjeteve ka qenë 100% (Kadastri i ndërtesave, Matjet relative gravimetrike, Zhvillimi i gjeoportalit, Zhvillimi i SITKT, Aerofotografimi).

Pas shkurtimeve buxhetore që janë bërë nga Qeveria, në pamundësi të realizimit të projekteve me vetëm 20% të buxhetit nga vlera e planifikuar, kemi përgatitur kërkesën për transferimin/rialokimin e mjeteve nga projektet kapitale. Nga "RIK" është kërkuar të transferohen mjetet të projekti "Skenimi i dokumenteve arkivore". Kërkesa është aprovuar dhe projekti "Skenimi i dokumenteve arkivore" është realizuar.

Përgatitja e Raportit Vjetor Financiar për periudhën Janar- Shtator 2017.

Pas aprovimit nga AKK raporti përcillet në MMPH dhe te Zyra Kombëtare e Auditimit. Pas shkurtimeve buxhetore që janë bërë nga MF, kemi rishikuar kërkesën për planifikimin e buxhetit për vitin 2018-2020. Është bërë korrigjim të projektet kapitale, ku në listën e projekteve kapitale janë vendosur edhe projekte që nuk kanë mundur të realizohen për mungesë buxheti në vitin 2017. Masa monetare e mjeteve të kjo kategori nuk ka ndryshuar nga planifikimi fillestar. Projektet janë vendosur edhe SIMFK, PIP – MF.

1.1 Aktivitetet e përgjithshme

Pjesëmarrja në grupin punës në hartimin e Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në MMPH, si dhe pjesëmarrja në grupin punës për Sistematizimin e vendeve të punës në MMPH- AKK, pas hyrjes në fuqi të Rregullores për organizim dhe sistematizimin e vendeve të punës në MMPH

Pjesëmarrje në Hartimin e planit për ndërtimin e objektit të Agjenc-

Realizimi i buxhetit nga Buxheti i BB për vitin 2017 është në vlerë prej: 924 492.26€ (83%)

Totali i buxhetit të ndarë nga dy fondet(BK-BB) është në

SHITJE E
PRODUKTEVE
69,265 €

Licenca në vlerë prej: 3,750,00 €.

Të hyrat e planifikuara për vitin 2017 kanë qenë në vlerë prej 47 000.00€, dhe AKK ka pasur rritje në të hyra në vlerë prej 26 015.00€ apo 52 % nga vlera e planifikuar.

Faktorët ndikues në rritjen e të hyrave kanë qenë vendosja e produkteve të reja në listën e shërbimeve si: shërbimet e KOPOS-it, hartat topografike, certifikatat e pronësisë, kopje plani dhe shërbime tjera për pjesën veriore të Mitrovicës etj.

TË HYRAT
73,015.00

cisë Kadastrale të Kosovës, "Projekti ideor për Agjencin Kadastrale të Kosovës ".Projekti është dorëzuar në AKK nga MMPH dhe është pranuar, pas aprovimit të komisionit pranues.

Në cilësinë e anëtareve të grupeve punuese, pjesëmarrje në hartimin e Udhëzimit Administrativ për produkte dhe shërbime të AKK-së dhe pjesëmarrje në grup punës për plotësimin e Regjistrimit të të drejtave të paluajtshme, lidhur me përcaktimin e gjinisë.

Pjesëmarrës në hartimin e draft-Udhëzimit Administrativ për Kërkesat Themelore për Shëndet dhe Siguri, Procedurat dhe Dokumentacionin për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje të Kategorisë I dhe II dhe Draft-Udhëzimit Administrativ për Kërkesat Themelore për Shëndet dhe Siguri, Procedurat dhe Dokumentacionin për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje të Kategorisë III.

1.2 Realizimi i buxhetit

Agjencia Kadastrale e Kosovës financohet nga dy fonde burimore, nga BK (10) dhe BB (41) Donacion. Buxheti i ndarë për AKK-në nga granti i qeverisë - BK ka qenë në vlerë prej 843 290.48€. Realizimi i buxhetit nga BK për vitin 2017 është në vlerë prej 778 014.40€, (92%) Buxheti i ndarë për AKK-në nga granti i BB ka qenë në vlerë prej: 1 108 502.29€

vlerë prej: 1 951 792.80€ (843 290.48 BK, 1 108 502.29 BB)

Koment: Mjetet e pasqepënuar nga donacioni barten në vitin vijues 2018. Numri i lëndëve të realizuara- pag-

Numri i të
punësuarve
në Agjencinë
Kadastrale të
Kosovës është 55

esa nga BK dhe BB- Huamarrja ka qenë: 468 (207 BK, 261BB)

1.3 Të hyrat

Gjatë viti 2017 ka pasur gjithsej 73,015.00 € të hyra. Të hyrat janë realizuar nga dy kategori të të hyrave si: Shërbime për shitjen e produkteve në vlerë prej :69,265,00 €,

1.4 Auditimi

MF bazuar në Vendimin e Qeverisë ka
reduktuar mjetet nga buxheti i AKK-ës të
projektet kapitale.

Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2017 ka realizuar disa auditime. Objekt auditimi kanë qenë të gjitha sektorët e Drejtoratit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme (per-

LICENCA NË
VLERË 3.750€

soneli, buxheti, logjistika, prokurimi) Zyra e auditorit të përgjithshëm ka realizuar dy auditime gjatë vitit 2017. Auditimi i parë është bërë në muajin mars, ku është audituar Raporti vjetor – pasqyrat financiare të viti 2016 përfshira buxhetin, prokurimin, personelin, logjistikën. Auditimi i dytë është realizuar në muajin Shtator. Objekt auditimi ka qenë Raporti vjetor financiar Janar-Shtator 2017, të përfshira në auditim: personeli, buxheti, prokurimi, të hyrat, pasuria, logjistika. Janë realizuar takime zyrtare me zyrtar të Zyrës Kombëtare të Kosovës, me auditorin e Bankës Botërore lidhur me pagesat që i kemi realizuar.

1.5 Prokurimi

AKK ka dorëzuar raportin vjetor mbi kontratat e nënshkruara publike për aktivitetet e prokurimit publik të AKK-së për vitin fiskal 2016 në Komisioni Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP). Ky raport është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për Prokurim Publik, duke paraqitur një analizë mjaft të detajuar mbi të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara në AKK, sipas kontratave të nënshkruara publike gjatë vitit 2016.

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) Brenda 15 ditëve pas shpalljes së miratimit të buxhetit për vitin fiskal, ka përgatitur dhe dorëzuar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit (AQP)

REALIZIMI I BUXHETIT (92%)

Planifikimin Final të Prokurimit, duke u bazuar në kërkesat e njëjse kërkuese (departamentet tjera) të aprovuara nga personat përgjegjës për buxhet dhe Drejtorit të Përgjithshëm (KE). Planifikimi i prokurimit ka qenë konform buxhetit të AKK-së për vitin fiskal në fjalë. Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) bazuar në planifikimin final të prokurimit për vitin fiskal 2017 ka filluar me aplikimin e prokurimit elektronik ku janë realizuar 12 aktivitete të prokurimit dhe një anulim. Secili proces i prokurimit në AKK është administruar përmes këtyre hapave në vijim: Planifikimi i Prokurimit, Parashikimi i Vlerës dhe Klasifikimi i Kontratës, Përcaktimi i Procedurës së Prokurimit, Përgatitja e Dosjes së Tenderit, Publikimi, Hapja dhe Vlerësimi i Tenderëve, Dhënia dhe Nënshkrimi i Kontratës, Menaxhimi i Kontratës. Duke u bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës, AKK ka paraqitur të gjitha kontratat e nënshkruara, duke përfshirë edhe ato me vlerë minimale.

2. ZHVILLIMI DHE HARMONIZIMI I MËTUTJESHËM I INFRASTRUKTURËS LIGJORE MBI PRONËN E PALUAJTSHME

Agjencia Kadastrale ka bërë zbatimin e vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/134, ku të gjitha pronat e paluajtshme (802 njësi kadastrale) të regjistruara në emër të ish RSFJ janë regjistruar si pronë në emër të Republikës së Kosovës.

Në kuadër të këtij ndryshimi është ndryshuar edhe emri i 610 parcelave nga të cilave u është hjequr shtesa "shumsko Srbija".

Nxjerrja e të dhënave nga Regjistri për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme dhe përgatitjen e materialeve për palë të ndryshme (të tilla si: Policia e Kosovës, përmbartues privat, persona tjerë fizik dhe juridik, EULEX-it, Gjykatave etj me 171 kërkesa, Administrata Tatimore e Kosovës 149 shkresa me gjithsej 1253 kërkesa, Agjencia Kundër Korrupsionit me informata për afër 1000 persona, Agjencinë Kosovare të Inteligjencës me 50 kërkesa, AKP me 64 shkresa me mbi 100 kërkesa).

Monitorimi në baza ditore i punëve dhe aktiviteteve të kryera nga Zyrtar Komunalet Kadastrale (ZKK-të) si dhe mbështetja e Zyrtarëve të ZKK-ve për llojet e ndryshme të kërkesave nga ata lidhur me mirëmbajtjen e rregullit në SIKTK.

Me datë 07.06.2016, AKK duke u bazuar në dispozitat ligjore ka marrë vendim që të pranohen kërkesat e qytetarëve të tri komunave veriore të Republikës së Kosovës: Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan që ti drejtohen AKK-së për Regjistrimin e të Drejtës mbi Pronën e Paluajtshme dhe shërbimeve të tjera kadastrale sipas kërkesave të tyre si dhe

ti lëshohen dokumente kadastrale. Gjatë vitit 2017 sipas 104 kërkesave të palëve janë lëshuar 202 certifikata të pronës dhe janë azhurnuar 60 lëndë për këto 3 komuna.

Me datën 18.08.2017 AKK ka marrë vendimin me numër protokollit 01/1777/17 për fillimin e monitorimit mbi aktivitetet kadastrale në ZKK. Monitorimi është realizuar në 35 ZKK në të gjithë Kosovën. Grupi monitorues ka qenë i përbërë nga Drejtori i drejtoriatit të pronave të paluajtshme në AKK, ekspertë të kadastrit dhe GIS-it dhe zyrtar të lartë ligjor. Nga aspekti i pjesës grafike janë kontrolluar 200 lëndë dhe nga ana ligjore 222 lëndë. Gjithashtu është monitoruar edhe pjesa e futjes së lëndëve në sistemin SIKTK-T. Raportet nga monitorimi i ZKK-ve u janë dërguar të gjithë kryetarëve të komunave dhe drejtorëve të drejtoriatit të kadastrit për komunën përkatëse me të gjitha të gjeturat dhe rekomandimet.

AGJENCIA KA MONITORUAR 35 ZKK

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) duke ju referuar Nenit 1 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.2002/5 Për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme autorizohet që të bëjë administrimin e gjithmbarshëm të Regjistrimit në pajtim me dispozitat e ligjeve në fuqi. Zyra Komunale Kadastrale (ZKK) do të regjistroj të drejtat e pronave të paluajtshme në Regjistrin sipas autorizimit të AKK-së dhe në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe udhëzimeve administrative të nxjerr nga AKK-ja.

AGJENCIA KUNDËR KORRUPCION KA BËRË KËRKESA PËR 1000 PERSONA

AKK, përkatësisht Drejtorati Ligjor (DL) duke ju referuar Nenit 6 paragrafi 6.1 Ligjit Nr.2002/5 Për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e marrjes së vendimit me shkrim të ZKK-së mbi refuzimin e regjistrimit të së drejtës së pronës së paluajtshme, parashtuesi i kërkesë mund të kërkojë nga AKK-ja të bëjë rishikimin e vendimit të ZKK-së.

Drejtorati Ligjor (DL) vepron në harmoni me dispozitat ligjore të legjislationit në fuqi si: Ligji me nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronave të Paluajtshme, Ligji me nr. 04/L-013 për Kadastër, Ligji 2002/4 për Hipotekat dhe Ligji me nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pa anashkaluar edhe ligjet tjera materiale, si: Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Pronësore, Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligji për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit etj.

2.1 Punët primare të Departamentit ligjor:

1. Shqyrtimin e kërkesave, ankesave dhe parashtresave të personave fizik dhe juridik, si organ i shkallës së dytë në Procedurë Administrative;
2. Komentimi dhe sqarimi i ligjeve, udhëzimeve administrative për nevojat e ZKK-ve, Ministrive dhe palëve;
3. Dhënia e këshillave profesionale drejtorive të AKK-së dhe ZKK-ve;
4. Kryerja e punëve që kërkojnë në bazë të projekteve që janë në zhvillim në AKK;
5. Përgatitja e raporteve, informatave dhe statistikave për drejtoriatin dhe AKK-në ;
6. Duke ju referuar Vendimit me nr.01/808/16 të dt.07.06.2016 të nxjerr nga Kryeshefi Ekzekutiv i AKK-së, Drejtorati Ligjor shqyrton kërkesat për Regjistrimi e pronave të paluajtshme për ZKK-të në pjesën veriore (Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq) deri te funksionalizimin si ZKK;
7. Shqyrtimi i aktvendimeve të lëshuara nga AKK , sipas kërkesave të palëve ne rast te paraqitjes se provave te reja;
8. Parashtrimi i përgjigjeve në padi dhe përfaqësimi në procedurën e konfliktit administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative.

Në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, përkatësisht në Drejtoratin Ligjorë janë shqyrtuar 1034 lëndë të natyrave të ndryshme, duke përfshirë ankesa ndaj vendimeve të ZKK-ve duke vendosur si shkallë e dytë, kërkesa për korrigjim të të dhënave dhe regjistrim të pronave të paluajtshme për 3 ZKK-ët Veriore, kërkesa për vlerësim të ligjshmërisë së vendimeve të Komunave të Kosovës për sistemin e adresave, mendime profesionale për ZKK-ët, përgjigje në padi dhe përfaqësim në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, përfaqësim të Agjencisë në takime, punëtori dhe simpoziume të organizuara nga Institucionet tjera të Kosovës si dhe çështje të tjera të cilat janë në kompetencë të Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Më poshtë i gjeni të paraqitur punët primare nga DL:

1. Ankesa/kërkesa për regjistrim të të drejtës në pronën e paluajtshme, të shqyrtuara 261 lëndë ;
2. Ankesa/kërkesa për korrigjim i gabimeve teknike, të shqyrtuara 4 lëndë ;
3. Përgjigje në kërkesë / ankesë të shqyrtuara 123 lëndë;
4. Njoftime lidhur me procedurën e zhvilluar lidhur me ankesën/kërkesën e palës/ZKK-së, të lëshuara 144 ;
5. Konkluzion – pezullim i Procedurës Administrative 49 lëndë;
6. Uzurpim i tokës në pronësi shoqërore, të shqyrtuara 15 lëndë;
7. Kërkesa për plotësim lënde nga palët dhe ZKK-ët, të lëshuara 152 lëndë;
8. Kërkesa për vlerësim të ligjshmërisë së Vendimeve të Komunave për Sistemin e Adresave parashtuar nga MAPL dhe Kërkesa për verifikim në AKP-ë 34;
9. Përgjigje në padi për Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative 108 padi ;
10. Përfaqësim në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative 92 përfaqësim;
11. Regjistrim/korrigjim për tre ZKK Veriore deri në formimin e tyre 42 lëndë;
12. Mendim profesional /Rekomandim për ZKK-ët 40;
13. Janë lëshuar edhe 32 Licenca për gjeodetët dhe Kompani të Licencuara.
14. Gjithsej janë vendosur në afat ligjor 1066 lëndë.

2.2 Punët e veçanta të kryera nga Departamenti Ligjor:

Angazhimi në cilësinë e anëtarëve të grupeve punuese:

1. Projektligji për Infrastruktura Kombëtare të Informacioneve Hapësinore (është përfunduar dhe dërguar në Qeveri, ku kemi qenë hartues i këtij projektligji);

2. Projektligji për Kadastër në Paluajtshmëri (ka kaluar edhe fazën e "Diskutimit Publik" tani më pritët që të shkoj në Qeveri, ndërsa DL ka qenë hartuese e këtij projektligji);

3. Projektligji për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje (DL ka qenë pjesë e grupit punës);

4. Projektligji për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale (DL ka qenë anëtare e grupit punës);

5. Udhëzimi Administrativ për Tarifat e Produkteve dhe Shërbimeve të AKK-së (DL ka qenë hartuese e këtij Udhëzimi Administrativ);

6. Marrja me zbatimin e Vendimit të Qeverisë për regjistrimin e pronave të ish RSFJ-së në emër të Republikës së Kosovës;

7. Monitorimi i Zyrave Kadastrale Komunale (monitorimi 2017) për 38 Zyra Komunale Kadastrale (ku gjithëherë ka qenë nga një zyrtar ligjor në komisioni monitorues) ;

8. Arkivimi i të gjitha lëndëve të Zyrës Ligjore deri në vitin 2013;

2.3 Punë tjera të rastit

1. Përgatitja e planit legjislativ për vitin 2018;

2. Takim me donator nga Banka Botërore dhe Qeveria Norvegjeze;

3. Takime me Ministrinë e Pushtetit Lokal , Bujqësisë dhe Ministrive tjera ;

4. Përfaqësimi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës në punëtori të ndryshme lidhur me zbatimin, plotësimin dhe ndryshimin e Ligjeve, iniciuar nga Instrucone të ndryshme të Republikës së Kosovës;

5. Takime me zyrtar komunal, palë dhe punë tjera të rastit për konsultime lidhur me çështjet e Regjistrimit të së Drejtës së Pronës së Paluajtshme.

JANË SHQYRTUAR 1034 LËNDË



3. ZGJERIMI I SISTEMIT TË SISTEMIT TË INFORMACIONEVE KADASTRALE TË TOKËS NË KOSOVË DREJT ARKITEKTURËS TË ORIENTUAR NË SHËRBIME (SIKTK-AOSH) (KCLIS – SOA)

- Është në progres e sipër mirëmbajtja e sistemeve kadastrale për funksionimin e rregullt të kadastrit digjital në Kosovë (SIKTK, Sistemi i adresave, Gjeoportali etj.). Kontrata për mirëmbajtje ka filluar më 11.10.2016 dhe do të zgjasë deri më 11.10.2019.

- Mirëmbajtja e Aplikacioneve Microstation dhe Map for Microstation

- Me përkrahje të projektit FRECAP është përfunduar projekti për zgjerimin dhe avancimin e aplikacionit, Sistemi i Informacionit Kadastral për Tokën në Kosovë (SIKTK) në drejtim të Arkitekturës së orientuar në shërbime (SOA). Projekti ka fillu-

ar me 15 Nëntor 2016 dhe ka përfunduar me 30 Tetor 2017. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës grupi punues i AKK-së ka mbikqyrë dhe ka testuar në vazhdimësi sistemin e ri duke dhënë komentet dhe vërejtjet e veta. Gjithashtu me kërkesë të BB-së është realizuar një auditim i pavarur teknik i sistemit nga të gjeturat e të cilit konstatohet që sistemi është i gatshëm për implementim. Nga ky zhvillim i ri rrjedha e punës gjatë mirëmbajtjes së informacioneve kadastrale, i përmbahet një rrjedhe të sigurt, të saktë, në përputhshmëri me ligjet në fuqi, duke pamundësuar kështu edhe mundësinë e gabimeve eventuale. Dhe gjithashtu lehtësohet

qasja në informacion, fleksibilitet në shfrytëzim dhe kohë më e shkurtër e mirëmbajtjes (azhurnimit) së të dhënave kadastrale.

IMPLEMENTIMI
I SIKTK
SOA KA
PËRFUNDUAR
ME 30 TETOR

POS NGA BUXHETI I KOSOVËS, ZGJERIMI I SISTEMIT INFORMATIV
ËSHTË BËRË EDHE ME PËRKRAHJE TË PROJEKTIT RECAP

4. SISTEMI I INFORMACIONEVE KADASTRALE TË TOKËS NË KOSOVË - HARTA KADASTRALE

Me përkrahje të projektit RECAP është përfunduar projekti për konvertimin dhe migrimin e të dhënave grafike kadastrale në aplikacionin Harta Kadastrale (Cadastral Map) për ZKK-në Pejë. Projekti ka filluar me 13 Mars 2017 ka përfunduar në Qershor 2017. Pasi që një numër i madh i njësive kadastrale për pjesën grafike në ZKK Pejë, kanë qenë të grumbulluara dhe të ruajtura në formate të ndryshme kompjuterike (kryesisht dëg), të dhëna të cilat janë krijuar nga ZKK Pejë në periudhën e pas luftës e deri në fillimin e projektit, por nuk kanë mundur të migrohen në SIKTK-HK, projekti RECAP i BB përmes AKK-së ka mbështetur ZKK-në që ato të dhëna të konvertohen dhe migrohen në sistemin zyrtar SIKTK-HK, përmes të cilit sistem të dhënat ka-

dastrale mund të jenë të qasshme përveç për zyrtarët e ZKK-së ashtu edhe për qytetarët përmes Gjeoportali Shtetëror. Në bazë të kontratës për projektin "Konvertimi dhe

Migrimi i të dhënave kadastrale në SIKTK-HK, ZKK Pejë", janë konvertuar dhe migruar në SIKTK-HK për 70 Zona Kadastrale, gjithsejtë 52,523 parcela, si dhe 804 ndërtesa në kuadër të 14 Zonave Kadastrale .

35 ZKK JANË
TRAJNUAR
PËR HARTËN
KADASTRALE



5. ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS

KOMBËTARE TË TË DHËNAVE HAPËSINORE

-IKIH (ANG.NSDI) DHE GIS-IT

Me përkrahje të projektit RECAP janë blerë paisje (hardëare dhe softëare) lidhur me përmirësimin e shërbimeve për shfrytëzuesit e rrjetit permanent të GPS-it – KOPOS (Kosovo Positioning System). Përveç përditshmërisë së adresimit lidhur me mirëmbajtjen e funksioneve dhe të dhënave në ARIS (Address Register Information System), si dhe trajnimet e vazhdueshme me komunat, njësia e adresave menaxhon edhe punimet e kryera nga fondet e dy donatorëve të ndryshëm, Bashkimi Europian (BE) dhe Qeverisë Norvegjeze në lidhje me tabelat e rrugëve, numrat e hyrjeve dhe informimin e qytetarëve me adresa te reja në Kosovë.

Me fondet e BE, janë përfunduar tabelat e emrave të rrugëve për 14 komuna: Malisheva, Gjakova, Su-

hareka, Mitrovica, Glogoc, Podujevë, Rahovec, Dragash dhe Klokot. Komuna e Ranillugut nuk ka pranuar që të vendosen tabelat me emrat e rrugëve në alfabetin latin.



Me fondet e BE ka përfunduar vendosja e tabelave të numrave të adresave në 5 komuna: Deçan, Fushë Kosovë, Skenderaj, Kaçanik dhe Glogoc.

Kurse me fondet e Qeverisë Norvegjeze janë përfunduar vendosja e tabelave të numrave të adresave për 3 komuna: Vushtri, Lipjan dhe Hani i Elezit

Në një prej komunave (Hani i Elezit) është pilotuar edhe lidhja e Regjistrimit të Adresave me atë të Gjendjes Civile. Rezultatet e pilotit, do të shërbejnë për replikim të modelit në të gjithë Kosovën, në një periudhë afatgjate.

Është në implementim e sipër projekti për ngritjen e kapaciteteve në harmonizimin e të dhënave gjeohapësinore sipas Direktivës INSPIRE (EU 2007/2) me mbështetje të projektit IMPULS për shtetet e Ballkanit Perëndimor (Republika e Kosovës, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Bosnja Hercegovina dhe Serbia) i financuar nga SIDA Suedeze. Ky projekt ka filluar në qershor 2014 dhe përfundon në qershor 2018. Është në implementim e sipër projekti për ngritjen e kapaciteteve në harmonizimin e të dhënave gjeohapësinore sipas Direktivës INSPIRE (EU 2007/2) me mbështetje të projektit IMPULS për shtetet e Ballkanit Perëndimor (Republika e Kosovës, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Bosnja Hercegovina dhe Serbia) i financuar nga SIDA Suedeze. Ky projekt ka filluar në qershor 2014 dhe përfundon në qershor 2018.






I PRONAVE TË PALUAJTSHME

- Janë hartuar termat e referencës dhe specifikat teknike për projektin e rindërtimit të Informacioneve Kadastrale në 20 Zona Kadastrale në Komunat: Drenas, Kamenicë, Viti dhe Skënderaj. Zyra e prokurimit ka bërë shpalljen publike për këtë projekt mirëpo projekti është anuluar për shkak të zgjatjes së procedurave me ankesa që kanë shkaktuar pastaj mungesë të bugjetit.
- Gjatë periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2017 është përfunduar eksportimi i të dhënave të realizuara nga projekti RIK 20 ZK (i realizuar gjatë vitit 2016). Të dhënat janë azhurnuar në modulën CR Tool dhe pas kontrollit nga AKK-ë janë importuar në SIKTK.
- Po ashtu në fillim të këtij viti është bërë edhe dorëzimi i të dhënave në kopje fizike në Komunat Lipjan, Graçanicë, Klinë dhe Skënderaj për Zonat Kadastrale të përfshira në Projektin RIK.

Po ashtu në fillim të këtij viti është bërë edhe dorëzimi i të dhënave në kopje fizike në Komunitat Lipjan, Graçanicë, Klinë dhe Skënderaj për Zonat Kadastrale të përfshira në Projektin RIK.

Përveç me regjistrimin sistematik të pronave të paluajtshme, qytetarët mundët të bëjnë edhe regjistrimin sporadik, për secilët ditë pune në Komunat ku ndodhet prona e tyre

ZK Lluge-Lipjan



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË/ CERTIFIKATË/ CERTIFIKATE

Personi/ Osoba/ Person:

endes:
 erent Number:
 dmet:
 a koha e lëshimit/datum i vreme izdavanja/date and time submission:
 /Opština/Municipality:
 dastrale/Katastarska Zona/cadastral Zone:
 nunaile Kadastrale/Opštinska katastarska kancelarija:

Ihënat për Pronar

Emri i biznesit /Ime biznesa ne/business	Emri Ime First name	Gjinia Pol Gender	Emri i babës Ime oca Fathers name	Lloji i ID Vrsta ID ID Type	Nr. ID Br. ID ID No.	Shteti/Shtetësia apo regjistrimi Drzava/Drzavljanstvo ili registracija Country of Citizens or registration	Datëlindja/data e Datum rogjeja/d Brith date/found

7. SHPRONËSIMI

Bazuar në vendimin Nr.17/2017 datë:10.03.2017 të nxjerrë nga Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka marr përsipër që të bëjë kontrollën e kualitetit (nga aspekti teknik) të të dhënave të shpronësuar. Gjerë në fund të vitit 2017 AKK ka dërguar raporte për këto elabore të shpronësimit:

JANË BËRË ELABORATE SHPRONËSIMI

- o Plotësim dhe ndryshim i elabوراتit të shpronësimit: Segmenti C2B, Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër
- o Segmenti Prishtinë-Milloshëvë, Zona Kadastrale Mazgjit, ndryshim i vijës së shpronësimit të nënkalimi
- o Ndërtimi i Autostradës Prishtinë-Hani i Elezit, Segmenti C2C, në ZK. Doganaj, Koxhaj, Saponicë, Doganaj, Rekë, Nikaj dhe Biçec.
- o Shpronësimi për Stationin policor në Zonën Kadastrale Zubin Potok dhe
- o Shpronësimi për Stadiumin kombëtar në ZK. Bërnice e Poshtme.
- o Elabore të shpronësimit për rehabilitimin e rrugës nacionale N25.3 Segmenti Kllokot-Gjilan, Komuna: Kllokot, Zona Kadastrale Kllokot
- o Elabore të shpronësimit për rrugën rajonale R105 në zonat kadastrale: Zonat kadastrale: Kralicë dhe Polac i vjetër Zonat kadastrale: Novolan, Bruznik dhe Kollë Zonat kadastrale: Taraxhë, Duboc, Galicë dhe Beçiq.
- o Elabore të shpronësimit për rrugën Tranzit, Ferizaj
- o Segmenti: Hyrja në qytetin e Ferizajit Zona Kadastrale Prelez i Jerlive
- o Elabore të shpronësimit për rrugën Tranzit, Prizren

- o Elabore të shpronësimit për parcelën 668-0, ZK. Stanoc i Epërm
- o Elabore të shpronësimit për nevojat e ndërtimit të memorialit "Baza e I-rë e UÇK-së në Lladovc dhe memorialit "Kulla e Zahir Pajazitit në Orllan.
- o Elabore të shpronësimit për kompleksin memorial "Adem Jashari"
- o Elabore të shpronësimit në Zonën Kadastrale Banullë dhe Dobratin
- o Elabore të shpronësimit për Stadiumin në Obiliq
- o Elabore të shpronësimit për segmentin rrugor "Kërpimeh-Mitrovicë"
- o Elabore të shpronësimit për segmentin "Deçan-Kozhner"
- o Elabore të shpronësimit për zgjerimin e mihjes sipërfaqësore për eksploatimin e thëngjillit për prodhim të energjisë elektrike për nevojat të Koorporatës Energjetike të Kosovës, në Zonat kadastrale: Hade dhe Shipitull
- o Elabore të shpronësimit Ndërtimi i Autostradës Prishtinë-Hani i Elezit, Segmenti C3, në ZK. Paldenicë
- o Elabore të shpronësimit

plotësimit të ti sipas Rekomandimeve të AKK-së për ZK. Koxhaj, Doganaj, Saponicë, Rekë, Nikaj dhe Biçec.

- o Elabore të shpronësimit për lokacionin e ndarë në Z.K. Neqavc, Komuna e Hanit të Elezit, për ndërtimin e varrezave të Qytetit
- o Elabore të shpronësimit "Shtësa për Rëshqitje", Zona Kadastrale Kovaçec, Komuna Kaçanik
- o Elabore të shpronësimit për rrugën rajonale R105, Vushtri-Polac: Zona Kadastrale Kralicë Zona Kadastrale Polac i

Vjetër

Zona Kadastrale Taraxhë
Zona Kadastrale Duboc
Zona Kadastrale Galicë
Zona Kadastrale Beçiq
Zona Kadastrale Novolan
Zona Kadastrale Bruznik
Zona Kadastrale Kollë

JANË BËRË KONTROLLE KUALITETI


it për segmentin "Balincë-Pejë"

- o Elabore të shpronësimit për "Sharrprodhimin", Z.K. Dragash
- o Elabore të shpronësimit për të dhënat për shpronësim dhe regjistrim të servitutit për linjat kablore në:

Z.K.	Rahovec
Z.K.	Fushë Kosovë
Z.K.	Prishtinë
Z.K.	Graçanicë
Z.K.	Mitrovicë
Z.K.	Therandë
Z.K.	Drenas

Elabore të shpronësimit për: "Ndërtimi i Autostradës Prishtinë-Hani i Elezit", segmenti C3, sipas ndryshimit të elabوراتit në ZK. Gajre, Kaçanik, Gjurgjedell Komuna e Kaçanikut dhe ZK. Paldenicë dhe Pustenik të Komunës së Hanit të Elezit.

- o Elabore të shpronësimit për linjën e re të dyfishtë 110kV për NS Fushë Kosovë dhe atë Graçanicë.
- o Elabore të shpronësimit pas



8. KRIJIMI I SISTEMIT TË

ARKIVIMIT DIGJITAL

Me përkrahje të projektit RECAP është implementuar projekti për skanimin e dokumentacionit arkivor kadastral në 12 Zyra Komunale Kadastrale (ZKK) (Faza I). Projekti ka filluar me 06.12.2016 dhe ka përfunduar me 06.06.2017. Numri i përgjithshëm i faqeve të skanuara në këto 12 ZKK është 2 736 011 faqe. Me datën 18.09.2017 AKK ka nënshkruar kontrata për realizimin e projektit për "Skanimin e dokumenteve arkivore për zyrën kadastrale komunale Pejë dhe Suharekë" (Faza II).

Në muajin e parë të skanimit që përfshinë datat 18.09.2017-17.10.2017 për dy ZKK-të janë skanuar:

Nr	Lloji i lëndës	Numri i faqeve
1	RDPP për hipoteka (Librat)	390
2	Hipoteka (Lëndët)	21052
3	RDPP (Librat)	2018
4	RDPP (Lëndët)	170301
5	Regjistri i fletëparaqitjeve	2269
	Totali:	196030

Në muajin e parë të skanimit që përfshinë datat 18.09.2017-17.10.2017 për dy ZKK-të janë skanuar:

Nr	Lloji i lëndës	Numri i faqeve
1	RDPP për hipoteka (Librat)	2543
2	Hipoteka (Lëndët)	46513
3	RDPP (Librat)	6031
4	RDPP (Lëndët)	155054
5	Regjistri i fletëparaqitjeve	3248
	Totali:	213389




 Përdoruesi:

 Fjalëkalimi:

Qasja përmes domenit:





Në muajin e skanimit që përfshinë datat 18.11.2017-30.11.2017 për dy ZKK-të janë skanuar:

Nr	Lloji i lëndës	Numri i faqeve
1	RDPP për hipoteka (Librat)	-
2	Hipoteka (Lëndët)	21636
3	RDPP (Librat)	-
4	RDPP (Lëndët)	56050
5	Regjistri i fletëparaqitjeve	244
	Totali:	77930


Numri i përgjithshëm i dokumenteve të skanuara prej datës 18.09.2017-30.11.2017 është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Nr	Lloji i lëndës	Numri i faqeve
1	RDPP për hipoteka (Librat)	2933
2	Hipoteka (Lëndët)	89201
3	RDPP (Librat)	8049
4	RDPP (Lëndët)	381405
5	Regjistri i fletëparaqitjeve	5761
	Totali:	487349

Janë hartuar specifikat teknike dhe është bërë shpallja publike për skanimin e dokumentacionit arkivor kadastral (Faza II) në 12 ZKK.



9. SISTEMI I POZICIONIMIT SATELITOR TË KOSOVËS - KOPOS



Bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 11 për Tarifat e Produkteve dhe të Shërbimeve të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, të nënshkruar më 27.07.2017, në të cilin udhëzim janë edhe shërbimet e KOPOS-it, AKK nga 1 Shtatori ka filluar aplikimin e tarifave për shfrytëzuesit e sistemit.

Deri më tani janë të regjistruar 161 shfrytëzues, të cilët vazhdimisht i përdorin shërbimet e sistemit. Të hyrat e përgjithshme nga regjistrimet e bazuara në tarifat e cekuar në tabelën më poshtë janë: 62,000 Euro.

Lloji i shërbimit	Qmimi Euro	Shfrytëzues të regjistruar
Regjistrimi fillestar i shfrytëzuesit	20	161
Tarifa 12 mujore RTK - Saktësi e lartë	400	134
Tarifa 6 mujore RTK - Saktësi e lartë	250	12
Tarifa 1 mujore RTK - Saktësi e lartë	60	14
Tarifa 12 mujore - Rinex dhe Postprocesim	100	1
Tarifa 6 mujore - Rinex dhe Postprocesim	70	0
Tarifa 1 mujore - Rinex dhe Postprocesim	30	0

Deri më tani janë të regjistruar 161 shfrytëzues, të cilët vazhdimisht i përdorin shërbimet e sistemit. Të hyrat e përgjithshme nga regjistrimet e bazuara në tarifat e cekuar në tabelën më poshtë janë: 62,000 Euro.

Shfrytëzuesit e regjistruar deri më tani janë të profileve dhe fushave të ndryshme, duke filluar nga personat fizik e deri te institucionet e qeveritare.

Lloji shfrytëzuesit	Numri i shfrytëzuesve
Persona fizik	58
Komani private	64
Institucione Komunale	27
Ndërmarrje Publike	10
Institucione Qeveritare	2

10. GJEOPORTALI SHETËROR

Agjencia Kadastrale e Kosovës që nga viti 2013 ka të implementuar edhe Gjeoportalin Shtetëror në Republikës së Kosovës.

Gjeoportali është një ueb aplikacion përmes të cilit grumbullohen dhe shpërndahen të dhënat gjeohapësinore prodhuar nga institucione të ndryshme.

1.000.000
vizitorë në
Gjeoportali

Sa i përket kanalit tjetër të komunikimit, Gjeoportali Shtetërorë, për periudhën kohore janar-dhjetor 2017 i njëjti është vizituar nga 127.000 vizitorë unik me rreth 1.000.000 vizita. Shumica e këtyre përdoruesve janë nga Kosova, duke u pasuar nga Zvicra, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar dhe Shqipëria. Përveç AKK-së si një ofrues më i fuqishëm i të dhënave përmes Gjeoportalit Shtetërorë, ka pasur një

Numri i
institucioneve që
shpërndajnë të
dhëna është 8

rritje me ofruesit e tjerë të të dhënave si Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komuna e Prishtinës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, etj. Në gjeoportali ekzistojnë rreth 30 shtresa të të dhënave, ndër-

sa aktiviteti kryesor për një periudhë të shkurtër do të jetë ofrimi i blerjes së të dhënave hapësinore në internet.

Aktualisht në Gjeoportalin shtetërorë ka 50 të dhëna gjeohapësinore, me ofrues kryesor të të dhënave Agjencinë Kadastrale të Kosovës, pasuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, Agjencia Kosovare e Statistikave, Ministria e Bujqësisë, Agjencia Kosovare e Statistikave, Agjencia për Mbrojtjen e Ambientit, Komuna e Prishtinës etj. Të dhënat aktuale janë, ortofoto 2012, ortofoto 2009, harta topografike, kufiri shtetëror, kufiri komunal, zona kadastrale, zona urbane, kufiri i parcelave, numri i parcelës, rrugë, emër rrugë, adresë, vendbanim, hekurudhë, lume, liqe, dendësia e popullsisë, opullsiapërkompnë, popullsia për vendbanim, numri i femrave për komune, numri i meshkujve për komune, ujësjellës, ndriçimi, hotspotet e reduktuara, zonat e mbrojtura, zonat e veçanta, zonimi i parkut Mali Sharr, etj.

50 data sete në
Gjeoportali



ORTOFOTO 2012,
ORTOFOTO 2009,
ORTOFOTO 2004,
ORTOFOTO 2001,
HARTA TOPOGRAFIKE,
KUFIRI SHTETËROR,
KUFIRI KOMUNAL,
ZONA KADASTRALE,
ZONA URBANE, KUFIRI
I PARCELAVE, NUMRAT
E PARCELAVE, RRUGË,
EMËR RRUGË, ADRESË,
VENDBANIM, HEKURUDHË,
LUMË, LIQE, DENDËSIA E
POPULLSISË, POPULLSIA
PËR KOMUNË, POPULLSIA
PËR VENDBANIM, NUMRI
I FEMRAVE PËR KOMUNË,
NUMRI I MESHKUJVE PËR
KOMUNË, UJËSJELLËS,
NDRIÇIMI, HOTSPOTET
E REDUKTUARA, ZONAT
E MBROJTURA, ZONAT
E VEÇANTA, ZONIMI I
PARKUT MALI SHARR, ETJ.

11. ZHVILLIMI I TEKNOLOGJISË

SË INFORMACIONIT

Raporti vjetor (Janar-Dhjetor 2017) i Drejtoratit për Teknologji të Informacionit është hartuar duke u bazuar në 7 objektivat/aktivitetet e Planit të Punës, i hartuar në fillim të vitit 2017. Secili objektivi është elaboruar duke përshkruar aktivitetet e ndërlikura. Në fund të këtij dokumenti është prezantuar një gjendje e përmbledhur, në formë tabelare, e resurseve të Teknologjisë së Informacionit të AKK-së. Vlerësimi është bërë në fund të Dhjetorit të vitit 2017.

11.1 Administrimi Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit (TI)

DTI administron Uebin e AKK

Administrimi i infrastrukturës TI: infrastrukturës harduerike, sisteme dhe logjike në dhomën e serverëve (serverët, storage, switch-at, UPS qendror, sistemi i aklimatizimit, Firewalls, sistemet e sigurisë fizike, etj).

Gjatë vitit 2017 janë krijuar gjithsej 24 serverë të rinjë, për qëllimet si më poshtë:

6 serverë për projektin KCLIS-SOA (ambienti testues dhe real)
1 serverë për projektin Skanimi Masiv (Massive Scanning)
2 serverë për Intranet, versionin e avancuar
2 serverë për KOPOS, versionin e avancuar
13 serverë për menaxhimin e shërbimeve të infrastrukturës TI, kryesisht për replikim me DRC dhe monitorim të infrastrukturës TI
Administrimi i kopjeve rezervë (Backups) të të dhënave

Backup-i i të dhënave të AKK-së bëhet bazuar në Strategjinë për kopje rezervë e cila është e implementuar sipas rëndësisë së shënimeve. Fillimisht backup-i bëhet në disk (DataDomain) përmes softuerit Networker, ku bazuar në strategjinë gjenden të dhëna të cilat bëhen backup në baza ditore, javore dhe mujore ndërsa arkivimi në TAPE bëhet çdo 3 muaj. Gjatë këtij viti është bërë implementimi i sistemit Unitrends i cili bën backup serverët virtual (VM-at). Bazuar në strategji serverët bëhen backup në baza ditore.

Administrimi i infrastrukturës TI në rrjetin LAN në AKK (kompjuterët, printerët, skanerët, ploterët, fotokopjet, infrastruktura TI në dhomën e trajnimeve etj.), është realizuar sipas kërkesave të punonjësve të AKK-së.

Administrimi i Infrastrukturës TI në Zyrat Kadas-trale Komunale-ZKK (kompjuterët, printerët, skanerët, etj.)

Për shkak të ndërprerjes së përkrahjes së Microsoft për sistemin operativ Windows XP, është iniciuar dhe është në proces azhurnimi i sistemit operativ (SO) të kompjuterëve nëpër ZKK, respektivisht kalimi në Windows 7. Nga mbi 300 kompjuterë të cilët gjenden në ZKK dhe administrohen nga AKK, deri në fund të vitit 2017 shumica prej tyre janë avancuar/azhurnuar në SO Windows XP. Kanë mbetur të pa azhurnuar edhe 50 sosh.

Administrimi i infrastrukturës së TI për KOPOS

Gjatë këtij viti është bërë avancimi i sistemeve të KOPOS-it duke përfshirë kalimin e serverëve nga Windows Server 2008 në Windows Server 2012 si dhe është bërë azhurnimi i aplikacioneve për menaxhimin e shfrytëzuesve siç janë: SpiderWeb, Spider Business Center dhe GNSS Spider si dhe i Firmware-ve të pajisjeve në 7 pika në tërë Kosovën.

Administrimi i sigurisë së infrastrukturës TI dhe Sistemeve të Informacionit (SI), bazuar në politikat

DTI përkrah
përdoruesit e sistemit
dhe shërbimeve TI,
përfshi konsulentë
të jashtëm, OE/
zhvillues sistemesh të
TI, kompani private
gjeodete për RIK
dhe KN, etj.
DTI ka krijuar qasjet
e lejuara VPN për
OE (Operatorët
Ekonomik) të cilët
jane duke i zhvilluar
aplikacionet në AKK.
DTI ka krijuar
llogaritë e
përdoruesve për
qasje në sistemet e
caktuara të AKK-së
si dhe janë përgatitur
ambientet për
zhvillim dhe testim
sipas kërkesave të
projekteve.

per siguri TI te AKK. Administrimi i fjalëkalimeve per nivelin e larte te infrastrukturës TI.

Administrimi i ASA Firewalls përmes te cilave menaxhohet lejimi/ndalimi i qasjeve brenda rrjetit qeveritar si dhe administrimi i qasjeve nga jashtë rrjetit qeveritar (përmes Virtual Private Network - VPN) ne rrjetin e brendshëm.

Administrimi i përdoruesve/users , i qasjeve te tyre dhe i roleve te tyre (autentifikimeve dhe autorizimeve), ne te gjitha nivelet e qasjeve.

Është implementuar politika e sigurisë AAA (Authentication, Authorization, Accounting) ashtu qe të gjithë përdoruesit e domenit IPRR.ks ju imponohet ndryshimi i fjalëkalimit çdo 6 muaj si dhe është domosdoshmëri

DTI administron TI për KOPOS

niveli i kompleksitetit te fjalëkalimit.

Administrimi i licencave softuerike

Administrimi, gjegjësisht regjistrimi për klientët(PC) i licencave te Microsoft siç janë paketa Office, SQL Server 2008 dhe 2012, Windows 7, Windows 10 si dhe Windows Server 2008 dhe 2012 gjithashtu është bërë administrimi i licensave te Geomedias, ArcGis, RasterX, GeosFin, Bentley MicroStation

Avancimi/zgjerimi i infrastrukturës ekzistuese TI ne qendrën primare ne AKK

Është implementuar ne tërësi projekti 'Zgjerimi i qendrës se te dhënave (HW-SW)". Përmes këtij projekti është bërë furnizimi, instalimi dhe konfigurimi me harduer (HW) dhe softuer (SW) në qendrën primare të të dhënave të AKK (dhoma e serverëve), si ne vijim: 2 Blade Servers, kondicioner backup per dhomën e serverëve, rrjetëzimin e AKK përmes sistemit 'wireless' , sistem(lexues/shkrues dhe medium) per backup (kopje rezervë).

Me kete avancim te infrastrukturës TI janë mbuluar te gjitha nevojat infrastrukture per funksionalizimin e sistemeve te informacionit (aplikacioneve) qe janë duke u zhvilluar ne AKK.

Administrimi i Qendrës se Rimëkëmbjes ne rast Fatkeqesish (DRC).


- Me vendim te menaxhmentit te AKKse dhe me përkrahjen e Agjencise se Shoqerise se Informacionit (ASHI)/MAP, qendra e dytë e të dhënave në raste emergjente (DRC) është zhvendosur nga objekti i MPB (Deçan) në Qendrën Shtetërore të të Dhënave (Prishtinë). Vendimi për zhvendosje te DRC nga Deçani në Prishtine është marr pasi qe objekti ne Deçan nuk ka pasur mirëmbajtje dhe furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike. Përveç rritjes se sigurisë dhe qëndrueshmërisë se DRC, me këtë rast (pas zhvendosjes) është avancuar edhe mënyra e komunikimit në mes të dy qendrave të të dhënave me rikonfigurimin e komunikimit ndërmjet qendrës primare (AKK) dhe DRC-se duke implementuar replikimin ne nivel te makinave virtuale (VM) përmes teknologjisë SRM (Site Recovery Manager). Replikimi nga QP ne DRC behet sipas prioritetit te te dhënave dhe shërbime, ne periudha kohore duke filluar nga cdo 5 minuta deri ne cdo 4 ore.

11 .2 Administrimi I sistemeve te informacionit, databazave dhe qasjeve

Administrimi i SIKTK-T, SIKTK-DM dhe CR-Tool. Gjatë viti 2017, në sistemet e informacionit SIKTK-T dhe CR-Tool, janë zhvilluar dhe ekzekutuar 171 skripta përmirësuese (quickfix). Me këto përmirësime sistemi është avancuar kryesisht në aspektin e kualitetit të të dhënave kadastrale. Janë monitoruar në vazhdimësi procedurat e kopjeve rezerve të databazave si dhe performanca e sistemit. Nuk ka pasur rënie të sistemit KCLIS në 2017.

Administrimi i SIKTK-HK

Janë ofruar përkrahje kryesisht në nivel të përdoruesve (users). Testimi i ndërlidhjes së SIKTK-HK me SIKTK-SOA.



Administrimi i Gjeoportalit Shtetëror

Gjatë vitit 2017 janë publikuar gjithsej 10 shtresa të reja në Gjeoportali, 8 shtresa nga Agjencia e Statistikave të Kosovës nga regjistrimi i bujqësisë i vitit 2014, dhe 2 shtresa nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (Ortofotot 2014 dhe Pasqyrimi i hartave 1:2500 në hartën e Kosovës). Gjithashtu janë përmisuar dhe përditësuar të dhënat e paraqitura më herët në Gjeoportali. Rregullimi i shtresave në Gjeoportali se cilat duhet të jenë të kërkueshme dhe të shkarkueshme. Përmisime në mënyrën e paraqitjes së të dhënave në Gjeoportali se cilattribute duhet të shfaqen dhe cilat jo.

Administrimi i Share-Point Intranetit të AKK.

Është implementuar në tërësi projekti "Zgjerimi i Intranetit me module të reja". Moduli kryesor i zhvilluar është moduli i faturimit i cili është avancuar në teknologjinë më të re. Moduli i fa-

resetuar passwordi i 14 shfrytëzuesve, dhe ju është ndaluar qasja në ARIS 4 shfrytëzuesve, të cilët e kanë përfunduar punën në Sistemin e Adresave.

Administrimi i ueb shërbime

- Gjatë vitit 2017 janë zhvilluar 2 ueb shërbimeve të reja në pjesën e sistemit SIKTK-HK për nevojat të KCLIS-SOA.
- Me qëllim të rritjes së kualitetit të të dhënave për pronarët (titullarët), AKK ka kërkuar nga Agjencia për Regjistrim Civil, Agjencia për Regjistrim të Bizneseve dhe Departamenti për Regjistrimin e Organizatave Joqeveritare, qasje përmes ueb shërbimeve në të dhënat (regjistrat) e tyre (RC, RB dhe ROJQ). Qasjet janë realizuar, testuar dhe SIKTK-SOA konsumon dhe shfaq në kohë reale këto të dhëna.

Administrimi i ueb faqes së AKK-së

- Është administruar dhe monitoruar në vazhdimësi infrastruktura TI e ueb faqes së AKK

Kontrolli i kualitetit të të dhënave në nivel të databazave për SIKTK-T dhe CR-Tool

- Edhe gjatë vitit 2017 ka vazhduar aktiviteti i kontrollit të kualitetit të të dhënave në databazën e SIKTK-T si dhe përmirësimi i tyre sipas procedurave të vendosura.

Përgatitja e raporteve dhe statistikave me të dhënat nga databazat e SIKTK-T dhe CR-Tool

- Gjatë gjithë vitit janë realizuar raporte dhe statistika me të dhëna nga databaza e SIKTK-T, sipas kërke-

turimit ndodhet në fazën e testimeve përfundimtare. Pritet që nga gjysma e dytë e Janarit të 2018 të fillon të zbatohet për faturimin e pagesave për shërbimet e ofruara nga AKK.

Administrimi i SIRA - ARIS

- Gjatë vitit 2017 janë përditësuar serverët e ARIS-it me përditësimet e fundit të sistemit operativ. Gjithashtu janë futur 8 shtresa të reja nga Agjencia e Statistikave rreth regjistrimit të bujqësisë të vitit 2014 në mënyrë që këto shtresa më vonë të paraqiten në Gjeoportali. Gjatë gjithë vitit është bërë replikimi i të dhënave nga Regjistrimi i Adresave në Gjeoportali. Përmirësimi i paraqitjes (stilit) së shtresave të ARIS-it. Krijimi dhe mirëmbajtja e shfrytëzuesve të Sistemit të Adresave: janë krijuar 2 shfrytëzues të rinj, është

mes të SIKTK tekstuale dhe grafike, statistika përgatitore para kalimit në sistemin e unifikuar SIKTK-SOA, etj.


- Përveç statistikave dhe raporteve për nevojat të brendshme të AKK-së, bazuar në kërkesa, janë realizuar edhe statistika për institucione të jashtme, gjithsej 24 statistika. Për detajet shih tabelën në vijim:



DTI ADMINISTRON DRC-NË

save të projekteve dhe iniciativave të ndryshme të AKK. Kryesisht për qëllime të hulumtimit të cilësisë së të dhënave kadastrale tekstuale, monitorimit të ZKK-ve në aspektin e cilësisë së azhurnimit të të dhënave në SIKTK-T, divergjencat në të dhëna në

Institucioni	Nr. Statistikave
Agjencia për Barazi Gjinore	Periudha: Janar-Dhjetor 2017
OJQ 'POLIS'	2
OJQ 'CSD'	9
Rrjeti i Grave të Kosovës	1
Trepça	3
Avokati i Popullit/ Ombudsperson	2
Radio Evropa e Lirë	1
Forca e Sigurisë së Kosovës	1
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	1
Ministria e Drejtësisë	3
	1



Përgatitja dhe mirëmbajtja e ambienteve TI (HW dhe SW) për testim, zhvillim, trajnim dhe produksion (real).

- Gjatë zhvillimit dhe testimit të projektit të KCLIS-SOA janë krijuar/konfiguruar 6 serverë: 2 serverë për ambientet test dhe real të KCLIS-SOA, 2 serverë për databazat e KCLIS-SOA (ambientet test dhe real), 1 server për API-te aplikacionit si dhe një server është krijuar për replikim të të dhënave nga KCLIS-SOA në Gjeo-portal.

11.3 Përkrahja e përdoruesve të sistemeve dhe shërbimeve të TI

Përkrahja e përdoruesve të sistemit dhe shërbimeve TI në AKK

- Janë ofruar përkrahjet e vazhdueshme të përdoruesve në nivel të aplikacionit duke ju dhënë qasjen e caktuar, duke bërë resetimin e pasurorëve sipas kërkesave dhe nevojave, duke ju dhënë sqarimet e nevojshme në përdorimin e aplikacioneve. Sipas kërkesave është bërë po ashtu edhe administrimi i llogarive të e-mailave zyrtarë në domenin qeveritar 'rks-gov.net'.

Përkrahja e përdoruesve të sistemit dhe shërbimeve TI në ZKK.


- ZKK-të janë përkrahur në vazhdimësi në nivel të aplikacioneve duke ju krijuar qasjet e caktuara/të lejuara, resetimin e pasurorëve sipas kërkesave dhe nevojave. Në kuadër të përgatitjeve për implementimin e KCLIS-SOA i cili pritet të ndodh gjatë vitit në vijim, përveç përgatitjes së infrastrukturës TI për implementimin e sistemit të informacionit, është

paraqitur nevoja e riemërimit të llogarive të përdoruesve në të gjitha ZKK-të. Gjatë këtij procesi janë vizituar 26 ZKK ku, përveç riemërimit të llogarive sipas standardit emër.mbiemer, janë mbledhur edhe informatat për secilin zyrtar duke përfshirë: Nr. Personal, Telefonin, emaili zyrtarë si dhe të dhënat për kompjuter. Kanë mbetur edhe 9 ZKK për tu përmbyllur si aktivitet. Të gjitha të dhënat e mbledhura janë vendosur në AD (Active Directory).

- Gjatë vitit 2017, janë përkrahur ZKK-të nga aspekti i TI në 135 raste (kërkesa). Përkrahjet kanë pasur të bëjnë me formatime, konfigurime, regjistrime në domen, instalime të drajverave dhe programeve të nevojshme (KCLIS, RDPP, KCLIS-HK, etj.) në PC si dhe instalime dhe konfigurime të printerëve dhe skanerëve, si në tabelën në vazhdim:

Shfrytëzuesit e regjistruar deri më tani janë të profileve dhe fushave të ndryshme, duke filluar nga personat fizik e deri te institucionet e qeveritare.

ZKK	Numri i përkrahjeve me TI per ZKK
Periudha: Janar-Dhjetor 2017	58
Drenas	9
Ferizaj	4
Fushe-Kosove	14
Gjakova	3
Gjilani	10
Hani e Elezit	3
Istogu	2
Juniku	1
Mamusha	3
Mitrovica V.	5
Mitrovica	3
Obiliqi	9
Partesh	1
Peje	5
Podujeva	29
Prishtine	1
Prizren	5
Rahovec	14
Ranillug	1
Skenderaj	2
Viti	6
Vushtri	5



Përkrahja e përdoruesve të tjerë të sistemit dhe shërbimeve TI. (konsulentë të jashtëm, OE/ zhvillues sistemesh të TI, kompani private gjeodefe për RIK dhe KN, etj.)

- Janë krijuar qasjet e lejuara VPN për OE (Operatorët Ekonomik) të cilët janë duke i zhvilluar aplikacionet në AKK. Janë krijuar llogaritë e përdoruesve për qasje në sistemet e caktuara të AKK-së si dhe janë përgatitur ambientet për zhvillim dhe testim sipas kërkesave të projekteve.

11.4 Avancimi i SIKTK ne drejtim te SOA, (SIKTK-SOA)

Krijimin e infrastrukturës së nevojshme të TI si dhe përdoruesve e qasjeve: Instalimin dhe konfigurimin e ambienteve të TI për zhvillim, testim, trajnim dhe prodhim të SIKTK-SOA; Instalimi dhe konfigurimi i TFS (për versionin) dhe ruajtja e kodit burimor për SIKTK-SOA, si dhe dokumentimin e tij;

- Gjate zhvillimit dhe testimit të projektit të KCLIS-SOA janë krijuar/konfiguruar 6 serverë: 2 serverë për ambientet test dhe real të KCLIS-SOA, 2 serverë për databazat e KCLIS-SOA (ambientet test dhe real), 1 server për API të aplikacionit si dhe një server është krijuar për replikim të të dhënave nga KCLIS-SOA në Gjeoportali.
- Për qëllime të testimit të KCLIS-SOA nga ana e zyrave kadastrale komunale, është bërë krijimi i llogarive (accounts) të përdoruesve të rinj për ZKK Gjilan dhe Mitrovicë të cilat janë vendosur si pilot ZKK për testimin e SIKTK-SOA.
- Versionet e kodit burimor të SIKTK-SOA si dhe dokumentet përcjellëse të projektit, janë duke u ruajtur në TFS server.
- Instalimi dhe konfigurimi i lidhjes VPN dhe krijimi i qasjeve të lejuara për OE/kompaninë zhvilluese në serverin e dedikuar.

Pjesëmarrje aktive në grupin punues të AKK për monitorimin dhe përkrahjen e zhvillimit të SIKTK-SOA

Pjesëmarrje aktive në grupin punues për testimin dhe pranimin e versioneve të SIKTK-SOA, dhe dokumenteve të ndërlidhura, të zhvilluara, prodhuara nga OE 'DataProgNet' Për qëllime të përkrahjes së grupit punues të SIKTK-SOA në fazën e

pranimit të projektit, janë hartuar TeR për një konsulent për auditim të cilësisë së projektit. Auditori i angazhuar për një periudhë një mujore ka realizuar takimet me grupin punues të AKK dhe ka dorëzuar raportet sipas TeR.

11.5 Zhvillimi i Strategjisë së TI(2017-2021), Avansimi i arkitekturës ekzistuese të sistemit ne 'enterprise architecture' dhe zhvillimi i datamodellit per NSDI/IKIH

Menaxhimi i projektit në të gjitha fazat e zhvillimit të tij

- Janë organizuar takime të rregullta (2 javore) në mes të grupit punues të AKK-së dhe kompanisë për zhvillimin e projektit (Ordnance Survey Internacional), ku është diskutuar progresi i projektit si dhe hapat që duhet të ndermiren në vazhdim.
- Përcjellja e Planit të projektit në mënyrë që projekti të mos ketë vonesa deri në dorëzimin e produktit final

Koordinimi i takimeve/aktiviteteve të projektit në mes të OE zhvilluese (Ordnance Survey Internacional-OSI) dhe palëve të përfshira në projekt, brenda dhe jashtë AKK-së.

- Në mënyrë që të mbledhen informacione për gjendjen aktuale në AKK dhe të tregohet cila është ndërlidhja e AKK-së me ZKK-të dhe palët e interesit, janë organizuar një seri takimesh si në vijim:
 - o Takim me të gjitha drejtoratet dhe drejtorët në AKK, si dhe me kryeshefin ekzekutiv,
 - o Takime me dy ZKK të përzgjedhura nga AKK (ZKK Ferizaj dhe ZKK Fushë Kosovë)
 - o Takim me gjeodetët privat
 - o Takim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
 - o Takim me Agjencinë e tatimit në pronë si dhe
 - o Takim me Agjencinë e shoqërisë së informacionit

Pjesëmarrje aktive në grupin punues të projektit, përgjegjës për monitorimin e projektit, dhënien e imputeve në projekt, komentimin/pranimin e dokumenteve të prodhuara nga projekti.

- Gjatë të gjitha fazave të projektit janë pranuar gjithsej 13 dokumente siç janë: Project Plan, Inception Report, Current State Report, Stakeholder Engagement Report, Best Practice Report, Draft IT Strategy,

IT strategy, Enterprise Architecture, IT strategy Implementation Plan, Data Modelling Framework, Data Model Current State Report, Data Model Target State Report si dhe Kosovo NSDI Data Model. Të gjitha këto raporte janë komentuar, rishikuar dhe pranuar nga grupi punues i Projektit.

Aprovimi dhe implementimi i Strategjisë për TI 2017-2021

- Me vendimin e AKK-së

DTI PËRKRAH ZKK

nr.13/17 të datës 20.06.2017 është aprovuar për implementim Strategjia pesë vjeçare e AKK për Teknologji të Informacionit (2017-2021). Strategjia parasheh zgjerimin dhe avancimin e arkitekturës së sistemit të TIK, bazuar në zhvillimet dhe avancimet e sistemeve të informacionit të AKK, si dhe zhvillimin e datamodellit për Infrastrukturën Kombëtare të Informacioneve Hapësinore (IKIH/NSDI). Dokumenti "Plani i implementimit të Strategjisë për TI (2017-2021)" shërben si udhërrëfyes në arritjen e pesë objektivave strategjike që ka përcaktuar kjo strategji: zhvillimin e Kadastrit, zhvillimin gjeohapsinor, eQeverisjen, vetëfinancimin dhe IKIH/NSDI. Secili nga këto objektiva përbëhet nga paketat punuese (21 paketa punuese gjithsej), të cilat, varësisht nga prioritetet, janë planifikuar të realizohen në tri periudha të përcaktuara kohore, periudhën afatshkurtër (1-2 vite), periudhën afatmesme (2-4 vite) dhe periudhën afatgjatë (pas 5 vitesh), duke startuar menjëherë pas miratimit të strategjisë për implementim, gjegjësisht nga gjysma e dytë e vitit 2017.

- Bazuar në Planin për Implementim, janë filluar 70% e paketave punuese të planifikuara për periudhën afatshkurtër. Vlen të përmendet që në gjysmën e dytë të 2017 kemi filluar aktivitetet edhe me paketën punuese WPEG01 (Kosovo Government Bus) e cila ka qenë e planifikuar të startohet në periudhën afatgjatë. Për më shumë detaje shih Objektivin nr. 7.

11.6 Skanimi Masiv i Dokumenteve dhe zhvillimi i Aplikacionit për ndërlidhje me SIKTK

Krijimin e infrastrukturës së nevojshme të TI si dhe përdoruesve të qasjeve: Instalimin dhe konfigurimin e ambienteve për zhvillim, testim, trajnim dhe prodhim të projektit.

- Janë përmbushur në tërësi kërkesat e projektit (Lot1 dhe Lot2) për nevojat të infrastrukturës TI. Pjesëmarrje aktive në grupin punues të AKK-së, në të gjitha fazat e zhvillimit të projektit si dhe testimit dhe pranimin e produkteve përfundimtare të zhvilluara nga OE 'DataProgNet& GesPlan'
- Përkrahje në finalizimin e TeR për projektin
- Përkrahje në instalimin të aplikacionit, krijim të llogarive dhe roleve në aplikacion
- Përkrahje në testimin e

versioneve të aplikacionit si dhe në trajnimin e përdoruesve të tij

- Pranimi i kodit burimor të aplikacionit dhe vendosja në TFS 12.7 eKadastr/ eQeverisja/ Government Gateway (GG) Këtë vit, Qeveria e Republikës së Kosovës, gjegjësisht Agjencia e Shërbimit të Informacionit ASHI/MAP, ka kontraktuar Microsoft-in në një projekt 3 vjeçar për zhvillimin e Platformës së Interoperabilitetit (Government Gateway- GG). Qëllimi i projektit është shkëmbimi i të dhënave dhe shërbimeve qeveritare në mënyrë elektronike përmes ueb shërbimeve. Agjencia Kadastrale e Kosovës është njëra nga tri institucionet e para të cilat janë planifikuar për ndërlidhje në GG.
- Grupe punuese nga AKK të udhëhequra nga DTI kanë marrë pjesë aktive në takimet e përbashkëta me ASHI dhe përfaqësues të Microsoft për bashkë-

dimin e aktiviteteve për këtë projekt.

- Është vendosur që shërbimet e Regjistrimit të Adresave (RA) dhe të Gjeoportalit të ndërlidhen në GG
- Janë përgatitur ueb shërbimet dhe dokumentacioni përcjellës i Sistemeve të Informacioneve RA dhe Gjeoportali për ndërlidhje në GG
- Janë në proces përgatitjet e ueb shërbimeve të lejuara edhe nga ana e SIKTK.

Përkrahja e përdoruesve të sistemit dhe shërbimeve TI në AKK

12. GJITHPËRFSHIRJA NË TË DREJTA PRONËSORE

12.1 Barazia gjinore

Sipas LIGJIT Nr. 05/L -020 PËR BARAZI GJINORE, Neni 6, pika 2.1. (kuotën për të arritur përfaqësimin e barabartë të femrave dhe meshkujve) Agjencia Kadastrale e Kosovës në pozita udhëheqëse ka përmbushur obligimin ligjor.

12.2 Kanalet e komunikimit me palë

Sa i përket ngritjes së vetëdijes dhe marrëdhënieve me publikun për çështjet e kadastrit dhe regjistrimit të pronës, për periudhën Janar – Dhjetor 2017 janë mirëmbajtur kanalet e komunikimit me qytetarë si që është ueb faqja zyrtare Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Gjeoportali shtetërorë dhe faqes zyrtare në Facebook. Web faqja e AKK ka pasur rreth 150 vizitorë unikë në ditë. Në faqen e internetit janë publikuar të

gjitha aktivitetet, projektet, produktet dhe shërbimet e ofruara nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, legjislacioni që mbulon fushën e kadastrës dhe administrimin e tokës, aktivitetet e sektorit publik, ndërsa përditësohet në baza ditore në tri gjuhë, shqip, serbisht dhe anglisht. Në periudhën raportuese ka pasur rreth 20.000 përdorues unik, me rreth 150.000 shikime.

12.3 Implementimi i politikave gjuhësore

Agjencia Kadastrale e Kosovës po zbaton politikat gjuhësore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Me këtë nënkuptohet që shumica e informatave, veçanërisht ato që prekin të gjitha komunitetet, janë duke u ofruar në gjuhët zyrtare, përkatësisht në shqip dhe serbisht. Kur është e nevojshme, gjuhët e tjera zbatohen gjithashtu. E njëjta gjë aplikohet edhe kur zhvillohen shërbimet dhe produktet profesionale.



12.4 Publikime

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka botuar dhe publikuar dy libra profesional, atë për hartat topografike dhe atë për matje kadastrale. Librat u shpërndanë të gjithë ofruesve profesionalistë të shërbimeve kadastrale, siç janë ZKK-të dhe Gjeodetët e licencuar. Po ashtu është shtypur edhe një broshurë informative për aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2016.

13. BASHKËPUNIMI ME DONATORË

Projekti për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme në Kadastër (Real Estate Cadastre and Registration Project-RECAP) financohet nga Banka Botërore, respektivisht Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (International Development Association-IDA), ku marrëveshja financiare në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës është nënshkruar nga Ministria e Financave. Vlera e përgjithshme financiare e Projektit RECAP përbëhet nga Kredia në vlerë prej USD 6.74 milion dhe Granti në vlerë prej USD 5.51 milion. Ky projekt ishte edhe kredia e parë në Republikën e Kosovës nga Banka Botërore. Ratifikimi i projektit nga Parlamenti i Republikës së Kosovës është bërë më 6 maj 2011. Me implementim të tij është filluar me 1 korrik 2011 dhe pritet të përfshirë me 30 qershor 2018. Projekti ka përfshirë 3 komponente:

- A. Administrimi i tokave komunale (Dizajnimi dhe ri-inzhinjerimi i Zyrave Kadastrale Komunale, dhe regjistrimi sistematik i pronës së paluajtshme)
 - B. Korniza Institucionale e Agjencisë Kadastrale të Kosovës (Reforma Institucionale dhe Infrastruktura e Teknologjisë Informative për AKK-në) dhe
 - C. Menaxhimi i Projektit, Trajnimi dhe Informimi Publik (Menaxhimi i projektit dhe koordinimi i donatorëve, trajnimet dhe informimi publik)
- Bazuar në Dokumentin Vlerësues të Projektit (PAD), Agjencia Kadastrale e Kosovës si implementuese e drejtpërdrejtë e këtij projekti, ka realizuar në tërësi të gjitha aktivitetet sipas dinamikës së paraparë dhe rezultatet janë të prekshme në të gjitha komponentet e projektit. Shumica e indikatorëve të paraparë të projektit janë përmbushur me sukses, ku kjo reflektohet edhe në raportin e Bankës Botërore të të Bërit Biznes 2018, ku radhitja globale e Republikës së Kosovës për komponentën

me 29 nëntor – 8 dhjetor 2017. Është në implementim e sipër projekti për ngritjen e kapaciteteve në harmonizimin e të dhënave gjeohapësinore sipas Direktivës INSPIRE (EU 2007/2) me mbështetje të projektit IMPULS për shtetet e Ballkanit Perëndimor (Republika e Kosovës, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Bosnja Hercegovina dhe Serbia) i financuar nga SIDA Suedeze. Gjatë vitit 2017 janë mbajtur 5 takime të koordinatorëve shtetëror për koordinimin e të gjitha aktiviteteve të projektit në nivel regjional, si dhe 2 takime të Komitetit Drejtues të projektit. Për periudhën qershor 2017 – 2018 janë angazhuar 3 ekspertë

RECAP
PËRFUNDON
MË 30
QERSHOR, 2018,
NDËRSA JANË
REALIZUAR 99%
TË MJETEVE
TË PARAPARA,
SUKSES KY I
VLERËSUAR
SI NGA
INSTITUCIONET
NDËRKOMBËTARE
PO ASHTU
EDHE NGA ATO
VENDORE

Vlera e përgjithshme financiare e Projektit RECAP
përbëhet nga Kredia në vlerë prej USD 6.74 milion dhe
Granti në vlerë prej USD 5.51 milion.

3 EKSPERTË TË
ANGAZHUAR
ME IMPULS

e regjistrimit të pronës së paluajtshme është përmirësuar dukshëm nga vendi i 76 që ka qenë në vitin 2012, në vendin e 34 në vitin 2018. Gjatë vitit 2017 janë realizuar 4 misionë në AKK të ekspertëve të Bankës Botërore për monitorimin e progresit të projektit me 4-6 shkurt 2017, 15-19 maj 2017, 20 shtator – 3 tetor 2017, si dhe fillimin e përgatitjeve për projektin e ri REGIP (Regjistrimi i Pronës dhe të Dhënave Gjeohapësinore) në misionin e Bankës Botërore

IMPULS
PERFUNDON NË
QERSHOR, 2018

(2 për GIS dhe 1 për mardhënie me publikun) për përkrahje të aktiviteteve të këtij projekti. Gjithashtu gjatë vitit 2017 janë analizuar dhe harmonizuar të dhënat konform Direktivës së EU, INSPIRE për: parcelat kadastrale, zonat kadastrale, hidrografia, transporti rrugor urat (në proces) dhe tunelet. Një theks i veçantë ju është dhënë përkrahjes së Institucioneve tjera të Republikës së Kosovës të cilat merren me prodhimin apo shfytëzimin e të dhënave gjeohapësinore. Për këtë qëllim janë mbajtur edhe punëtori (workshop) në ambientet e AKK-së, ku është prezantuar gjeoportali shtetëror dhe gjeoserveri si dhe është demonstruar harmonizimi i të dhënave nga hidrografia. Ky projekt ka filluar në qershor 2014 dhe pritet të përfundojë në qershor 2018.


Si u përmend më lartë, me fondet e BE, janë përfunduar tabelat e emrave të rrugëve për 14 komuna: Malisheva, Gjakova, Suhareka, Mitrovica, Glogoc, Podujevë, Rahovec, Dragash dhe Klokot. Komuna e Ranillugut nuk ka pranuar që të vendosen tabelat me emrat e rrugëve në alfabetin latin.

përkrahjes së AKK-së në zhvillimin e mëtejshëm në sektorin e TI dhe regjistrin e adresave për periudhën 2018-2020.

Gjithashtu Qeveria e Holandës ka filluar me projektin përkrahës për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor në projektin MATRA, ku fillimisht do të bëhet identifikimi i aktiviteteve

që do të përkrahen nëpër të gjitha Agjencitë për Kadastrë në shtetet në rajon, nëpërmjet punëtorëve (workshopeve) që do organizohen për tema të caktuara profesionale nga fusha e kadastrit, regjistrimit, të pronës, regjistri i adresave, Infrastruktura e të dhënave gjeohapësinore etj.

BASHKIMI EVROPIAN PËRKRAH SISTEMIN E ADRESAVE



14. LOGJISTIKA

14.1 Raporti i pranimit të mallit

Agjencia Kadastrale e Kosovës gjatë viti 2017 ka regjistruar të hyr-mall në depo në vlerë prej 671 695.38€. Komfor Rregullores për menagjimin e pasurisë jo financiare, të gjitha hyrjet janë regjistruar në SIMFK (Sistemi i menagjimit të financave dhe kontrollit) - MF

14.2 Veturat

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka në dispozicion shtatë (7) vetura zyrtare. Gjatë viti 2017 janë realizuar 234 terrene, prej të cilave 225 brenda vendit dhe 9 jashtë vendit. Kilometra të kaluara kanë qenë 47758 km. Derivate të shpenzuara për kilometrat e kaluara kanë qenë në vlerën 5 323.01 liter, për 100 km: 11.15 litra

14.3 Arkiva - protokoli

Gjatë vitit 2017 janë pranuar gjithsejtë 2713 lëndë, ndërsa janë përcjellë nga AKK-ja 2063 lëndë; Është bërë pranimi i lëndëve - kërkesave dhe ankesave të palëve skanimi i tyre dhe shpërndarja e tyre në drejtori përkatëse,

14.4 Përkthimi i dokumentacionit nga gjuha serbe në gjuhën shqipe dhe anasjelltas

Gjatë viti 2017 janë përkthyer gjithsejtë 211 dokumente me 506 faqe përkthim.

211

DOKUMENTE TE PERKTHYERA

KCLIS-korrigjime /verzioni serb. dhe shqip/, në vazhdimësi. Raste përkthimi verbal (përkthim të aty për atyshëm) në Komunitat: Ranillug, Partesh, Novoberdë për mbarrëvajtjen e Aplikacionit të SIKTK-së si dhe Përkthime të ndryshme verbale në disa takime të rëndësishme për mbarrëvajtjen e punëve të organizuara nga MMPH dhe AKK për komunitet me shumicë të qytetarëve serbë apo serbisht-folës.

Me fondet e BE ka përfunduar vendosja e tabelave të numrave të adresave në 5 komuna: Deçan, Fushë Kosovë, Skenderaj, Kaçanik dhe Glogoc, kurse me fondet e Qeverisë Norvegjeze janë përfunduar vendosja e tabelave të numrave të adresave për 3 komuna: Vushtrri, Lipjan dhe Hani i Elezit. Jemi të informuar nga Autoriteti për Kadastrë dhe Hartografi i Norvegjisë (Kartverket), që Qeveria e Norvegjisë ka aprovuar projektin për vazhdim të

Qeveria e Holandës ka filluar me projektin përkrahës për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, MATRA

15. PLANI VJETOR I PUNËS SË

AKK PËR VITIN 2018

Objekti	Aktivitetet kryesore	Periudha Kohore	Buxheti dhe Financat BKK/ Donatorët)		Palët e tjera të përfshira	Dokumenti Referues	Rreziqet
		K1, K2, K3, K4					
1. Koordinimi institucional i administrimit të tokës në Republikën e Kosovës	1. Pjesëmarrja dhe udhëheqje e AKK-së në aktivitetet që kontribuojnë në koordinimin institucional të administrimit të tokës në Kosovë dhe IKIH, gjegjësisht komiteti ndërministror për administrimin e tokës etj.	2009-2018	BKK	Donatorët	AKK, MMPH, MAPL, MAP, MTI, MBPZHR, MEF, MD, MI, KPMM, ASK, AiKK, AKP, AKPV	Vendimi i Qeverisë nr.2/84 për Komitetin bashkërendues ndërministror për administrimin e tokës në R. E Kosovës	Moskoordinimi ndërinstytucional
2. Zhvillimi dhe harmonizimi i mëtejshëm i infrastrukturës ligjore mbi pronën e paluajtshme	1. Projektligji për Krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor (IKIH) në Republikën e Kosovës 2. Projektligji për Kadastër në Paluajtshmëri	2016-2018 2017 - 2018			AKK, MMPH, MAPL, MIE, MBPZHR, ASK, KPMM, ZKK AKK, MMPH, MAPL, MF, MIE, SHGJK, ZKK, AiKK, Oda e Noterëve etj.	Plani legjislativ 2017-2018	Vonesa në aprovimin e tij nga Parlamenti

3. Zhvillimi institucion- al i AKK-së si bartës kryesor i zhvillimit të Kadastrit dhe Administrimit të tokave në Kosovë	1. Ngritja e vetëdijes, dhe in- formimi i vazhdue- shëm i akterëve të involvual në ad- ministrimin e tokës lidhur me ecurinë e aktiviteteve në AKK. (informim publik, punëtori, seminare, trajnime etj.) 2. Mbikqyrje e punës së ZKK-ve lidhur me regjis- trimin e drejtave mbi pronat e pa- luajtshme konform ligjeve të apli- kueshme 3. Trajnimi dhe dhe përkrahja e ZKK-ve për frytëzimin e plotë të aplikacionit SIKTK-SOA për të dhëna tekstuale	2018			AKK, MMPH, MD, MAPL, MF, MBPZHR, MEF, AiKK, ZKK	-Strategjia zhvillimore dhe plani i biznesit të AKK 2013-2017,	Moskoor- dinimi ndërinsti- tucional
--	---	-------------	--	--	--	---	--

4. Zhvillimi i resurseve njerëzore dhe trajnimi i stafit të AKK	1. Ngritja e kapaciteteve në AKK dhe ZKK - zhvillimi dhe implementimi i programit trajnues - vizita studimore dhe konferenca vendore dhe ndërkombëtare - programe profesionale trajnuese mbrenda dhe jashtë vendit	2018			AKK, MMPH, ZKK	-Strategjia zhvillimore dhe plani i biznesit të AKK 2013-2017,	Financimi
5. Zhvillimi i më-tutjeshëm i Sistemit Informativ Kadastral të Tokës në Kosovë (SIKTK)	1. Mirëmbajtja e Sistemeve kadastrale për funksionimin e rregullt të Kadastrit digjital në Kosovë 2. Zhvillimi i Sistemit të Informacionit Kadastral për Tokën në Kosovë (SIKTK)-Faza 2. 3. Konvertimi dhe migrimi i të dhënave grafike kadastrale në aplikacionin Harta Kadastrale në 7 ZKK	2018	167.000 €		AKK, MMPH, ZKK	Strategjia zhvillimore dhe plani i biznesit të AKK 2013-2017,	
		2018	225.000 €				
		2018		60.000 €			

6. Regjistrimi sistematik i pronave të paluajtshme	1. Rindërtimi i Informacioneve Kadastrale në 15 Zona Kadastrale në Komunat: Drenas, Kamenicë, Viti dhe Skënderaj	2018	300.000 €		AKK, ZKK, AKKPV, AKP	-Strategjia zhvillimore dhe plani i biznesit të AKK 2013-2017,	
	2. Kadastri i ndërtesave (ZKK me shumicë të minoriteteve)	2018	50.000 €				
7. Zhvillimi i më-tutjeshëm i Sistemit Informativ Kadastral të Tokës në Kosovë (SIKTK)	1. Aerofotografimi i territorit të R. së Kosovës	2018	300.000 €		AKK, MMPH, MD, MAPL, MF, MBPZHR, MEF, AiKK, ZKK	Strategjia zhvillimore dhe plani i biznesit të AKK 2013-2017,	Moskoordinimi ndërinsti-tucional
	2. Zhvillimi i më-tutjeshëm i sistemit të Gjeoportalit	2018	25.000 €				
	3. Sistemi i Adresave në R. e Kosovës. Vendosja e tabelave të rrugëve për 4 Komuna dhe vendosja e numrave të hyrjeve të objekteve në 4 Komuna	2018		300.000 €			
	4. Matjet relative gravimetrike 5. Ngritja e kapaciteteve në harmonizimin e të dhënave gjeohapësinore sipas Direktivës INSPIRE (EU 2007/2). Projekti IMPULS për shtetet e Ballkanit Përendimor.	2018	60.000 €				
		2016-2018					

8. Krijimi i Sistemit të Arkivimit Digjital	1. Skanimi i dokumentacionit arkivor kadastral në 6 ZKK	2018	150.000 €		AKK, ZKK	Strategjia zhvillimore dhe plani i biznesit të AKK 2013-2017,	
9. Zbatimi i Strategjisë per TI (2017-2021)	1. Zgjerimi i qendrës së të dhënave (HW+SW) 2. Zgjerimi i Intranetit të AKK me module të reja 3. Programi për zhvillim dhe trajnim 4. Mirëmbajtje TI e dhomës së serverëve 5. Programi për përmirësimin e të dhënave kadastrale 6. Shkëmbimi ndërinstitucional i të dhënave përmes platformës së interoperabilitetit (GG-Government Gateway)	2018	100.000 7.000 10.000 7.000		AKK, ZKK, ASHI	Strategjia dhe plani i implementimit për TI (2017-2021)	



Tel: +383 38 512 353
Email: akk@rks-gov.net
www.kca-ks.org
<http://geoportal.rks-gov.net/>